



Shoqëria Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarna Dobrotvorna Udruženja Kosova "Nëna Tereze"
SHHBK është një agjencitë e pa fitim dhe pa kufizim.
Religjioziteti është e ndalojë nga SHHBK.

Republika e Kosovës - Republika kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 913/01-2300
Data/Datum 28-01-2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Memorandum Mirëkuptimi

E lidhur me datën 28.01.2022 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna
2. Shoqatës Humanitare Bëmirëse të Kosovës "Nëna Tereze", të cilën e përfaqëson Zef Shala Drejtor Ekzekutiv, në tekstin vijues theksohet: SHHBK "Nëna Tereze"

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është përkrahja e përbashkët nga palët për personat e moshuar dhe të vetmuar të atakuar edhe nga pandemia COVID-19, të cilët jetojnë në qytet apo viset rurale me fokus (Gratë që ju takojnë grupeve të cënueshme në shoqëri të të gjitha grupeve etnike).

Neni 2

Implementimi i projektit

SHHBK "Nëna Tereze" përmes punëtorëve të saj (Home Care) do të ju ndihmoi personave të kategorisë së lartë përmendur për të pasur qasje në institucionet publike dhe shëndetësore duke ju ofruar shërbime sipas kërkesës së tyre, bazuar në garantin e financuar nga zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Neni 3

Obligimet e Komunës

Komuna ka për obligim që përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS) dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), të siguroi evidencën - Listën e personave të moshuar dhe të vetmuar që jetojnë në qytet apo fshatra me fokus të veçantë personave të cilët e kanë të vështirësuar qasjen në institucionet publike Komunale.

Neni 4
Obligimet e SHHBK "Nëna Terezë"

SHHBK "Nëna Terezë" do të mbështesë personat e kategorive të tilla sipas mundësive programore të parapara në projekt. Përmes raporteve me shkrim do të njoftojnë institucionet Komunale, QPS-në apo DSHMS-në, në baza tre mujore mbi aktivitetet e zhvilluara për personat e përfshirë në projekt. Do të merr pjesë në takim me QPS apo DSHMS çdo herë kur kërkohet për të prezantuar të arriturat e projektit.

Neni 5
Koordinimi i veprimeve dhe bashkërendimi i ndihmës dhe përkrahjes

SHHBK "Nëna Terezë" do të njoftoi QPS-në apo DSHMS-në për personat përfitues nga projekti të përzgjedhur sipas kriterëve të parapara me rregullore të veçantë, me qëllim të shmangies së dyfishimit të mbështetjes eventuale nga burime të tjera jashtë këtij projekti.

Neni 6
Mbrojtja e të dhënave personale


Informatat dhe listat e pranuar të siguruar nga Komuna përmes QPS-ve apo DSHMS-ve për personat përfitues nga ky projekt, do të trajtohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 7
Dispozitat përfundimtare

- Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë nga të dyja palët, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.
- Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandum në rast se mosmarrëveshjet eventuale zgjidhen me mirëkuptim.
- Memorandumi i Mirëkuptimit është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje identike, nga një për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Palët Nënshkruese

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës
"Nëna Terezë" Prishtinë


Zef Shala
Drejtor Ekzekutiv

